REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 282, Datë 08.10.2026

MBI

MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "GREENNAT SOLAR PARK BALLSH" SH.P.K. NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 MW

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 59/2026 *"Për sektorin e energjisë elektrike"*; neneve 13 dhe 15 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 08.10.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1291/20 prot., datë 07.10.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k., është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, i ndryshuar, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në zonën kadastrale 1090, Njësia Administrative Ballsh, Bashkia Mallakastër, Qarku Fier.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1291 prot., datë 28.04.2026 dhe nr. 1291/2 prot., datë 18.05.2026, shoqëria ka paraqitur aplikim për modifikimin e licencës, duke kërkuar ndër të tjera dhe ndryshimin e numrit të paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar prej 100 MW, konkretisht nga **(**171 200 njësi x 585 Wp secila) në (42,735 njësi x 585 Wp secila dhe 120,967 njësi x 620 Wp secila).
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 146, datë 28.05.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.05.2026 dhe 01.06.2026). Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët nuk ka rezultuar të ketë të tilla.
- Në vijim është zhvilluar korrespondenca përkatëse me vetë shoqërinë dhe me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ku ERE me shkresën nr. 1291/11 prot., datë 14.07.2026, i është drejtuar MIE-s, për dijeni të shoqërisë, duke evidentuar se kontrata, në nenin 3 të saj, përcakton të dhëna të përgjithshme të centralit, por jo numrin dhe kapacitetin e njësive gjeneruese. Këto të dhëna parashikohen në Aneksin 3, por nuk kanë rezultuar të plotësuara në momentin e nënshkrimit të kontratës. Si e tillë, ERE i ka kërkuar MIE-s sqarimin përkatës në

rast se shoqëria duhet të marrë në mënyrë specifike qëndrimin e saj, ndër të tjera dhe për ndryshimin e numrit të paneleve.

- Me qëllim administrimin e një qëndrimit të MIE-s, bordi i ERE-s me vendimin nr. 202, datë 21.07.2026, vendosi të pezullojë procedurën deri në marrjen e qëndrimit nga ana e MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit.
- Në vijim, MIE, me shkresën nr. 4755/12 prot., datë 03.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/14 prot., datë 05.08.2026, ka sqaruar se, sipas kontratës nr. 31 Rep., nr. 13 Kol., datë 27.01.2023, parametrat teknikë/energjetikë mund të ndryshojnë me miratim të Ministrisë, me kusht që kapaciteti prodhues të mos kalojë 100 MW.
- Për më sipër, rezulton se MIE nuk ka dhënë sqarim specifik nëse ndryshimi i numrit të paneleve fotovoltaike, pa ndryshuar kapacitetin prodhues prej 100 MW, kërkon miratim paraprak apo procedurë tjetër administrative pranë saj, ndaj ERE, me shkresën nr. 1291/15 prot., datë 20.08.2026, i ka kërkuar asaj të sqarojë nëse ky ndryshim, sipas kontratës nr. 31 Rep., nr. 13 Kol., datë 27.01.2023, konsiderohet ndryshim i parametrave teknikë/energjetikë dhe nëse për këtë ndryshim kërkohet miratim paraprak apo procedurë tjetër administrative pranë MIE-s.
- Duke qenë se qëndrimi i MIE-s si më sipër është vlerësuar i nevojshëm për trajtimin e kërkesës së shoqërisë për ndryshimin e numrit të paneleve fotovoltaike, në pikën 6 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 243, datë 28.08.2026, është vendosur të pezullohet procedura deri në administrimin e qëndrimit përkatës të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë, duke filluar nga data 20.08.2026, datë kjo në të cilën ERE i ka përcjellë MIE-s kërkesën për qëndrim, ndërsa në pikën 7 është parashikuar që, me administrimin e qëndrimit të MIE-s ose, në çdo rast, me përfundimin e afatit të përcaktuar në pikën 6 të këtij vendimi, procedura administrative për pjesën e kërkesës së pezulluar rifillon dhe afati për vendimmarrjen vijon të llogaritet për pjesën e mbetur.
- ERE, ka njoftuar MIE-n për këtë vendim me shkresën nr. 1291/18 prot., datë 08.09.2026.
- Në vijim dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në vendim, nuk rezulton që nga ana e MIE-s të jetë depozituar ndonjë qëndrim.
- Për sa më sipër, vlerësohet se, me përfundimin e afatit 30-ditor të përcaktuar në vendimin e bordit të ERE-s nr. 243, datë 28.08.2026, dhe në kushtet kur, deri në përfundimin e këtij afati, MIE nuk ka përcjellë qëndrim lidhur me çështjen për të cilën është kërkuar sqarim, procedura administrative rifillon në përputhje me përcaktimet e këtij vendimi, pa qenë e nevojshme zgjatja e mëtejshme e pezullimit.
- Nga shqyrtimi i objektit të kërkesës dhe dokumentacionit të administruar rezulton se modifikimi për të cilin kërkohet vendimmarrja e ERE-s lidhet me përditësimin e të dhënave mbi numrin dhe fuqinë nominale të paneleve fotovoltaike, të pasqyruara në Aneksin A të licencës që administrohet nga ERE, pa ndryshuar kapacitetin e licencuar të centralit prej 100 MW. Ky modifikim nuk ka për objekt ndryshimin e kontratës së lidhur ndërmjet shoqërisë dhe MIE-s, as miratimin nga ERE të ndryshimeve të mundshme të parametrave kontraktorë, të cilat mbeten në kompetencën e autoritetit kontraktor.
- Në këtë kuadër, kërkesat për sqarim drejtuar MIE-s kanë pasur për qëllim verifikimin e detyrimeve të mundshme të shoqërisë sipas kontratës së lidhur me Ministrinë dhe përcaktimin nëse ndryshimi konkret kërkon miratimin e saj. Mungesa e një përgjigjeje specifike nga MIE nuk konsiderohet miratim i heshtur i ndryshimit të kërkuar dhe as përbën bazën për miratimin e tij nga ERE. Vendimmarrja e ERE-s kufizohet në përditësimin e Aneksit A të licencës, mbi bazën e dokumentacionit të administruar dhe në përputhje me kompetencat e saj rregullatore, pa cenuar detyrimet që shoqëria mund të ketë ndaj MIE-s sipas kontratës përkatëse.

- Në këto kushte, përfundimi i afatit të pezullimit përbën bazën procedurale për rifillimin e shqyrtimit të kërkesës, ndërsa vlerësimi për modifikimin e licencës mbështetet në objektin e ndryshimit të kërkuar, dokumentacionin e administruar dhe faktin se përditësimi i të dhënave në Aneksin A nuk ndryshon kapacitetin e licencuar të centralit prej 100 MW. Për rrjedhojë, vlerësohet modifikimi i Aneksit A të licencës për sa i përket numrit dhe fuqisë nominale të paneleve fotovoltaike, duke ruajtur të pandryshuar numrin e licencës, kapacitetin e licencuar dhe kushtet e tjera të saj.
- Nga analiza e aplikimit të kryer dhe më herët, në referencë të vendimit nr. 243/2026, ka rezultuar se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga "*Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike"*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, si e tillë vlerësohet modifikimi i licencës për ndryshimin e numrit të paneleve, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë Aneksin A të licencës Nr. 582, seria P 24, të shoqërisë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 132, datë 02.07.2024, i ndryshuar, duke ndryshuar konfigurimin ekzistues prej 171 200 paneleve me fuqi 585 Wp secili, në 42 735 panele me fuqi 585 Wp secili dhe 120 967 panele me fuqi 620 Wp secili, pa ndryshuar kapacitetin e licencuar të centralit prej 100 MW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "GreeNNat Solar Park Ballsh" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI